



Raport monitorues IV

mbi punën e ekzekutivit të komunës së Lipjanit

Tetor 2011

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Premtimet e Kryetarit Shukri Buja,
- Problemet aktuale,
- Përshkrim i realizmit të punëve ,
- Gjendja ekonomike dhe sociale ,
- Transparenca dhe llogaridhënia ,
- Buxheti i Komunës,
- Investimet kapitale,
- Administrata komunale,
- Komuna e Lipjanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale,
- Gjendja në arsim,
- Gjendja në shëndetësi,
- Tatimi në pronë,
- Rekomandimet,
- Burimet

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

webfaqja: www.ngoyahr.page.tl & www.ngoyahr.weebly.com

Hyrje

Në hartimin e këtij raporti të tretë për ekzekutivin e Komunës së Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2009/2013 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave

Profili i Kryetarit Shukri Buja



Shukri Buja u lind më 27.08.1966, në fshatin Bujan, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatrat Bujan dhe Kraishtë ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në gazetari dhe ka përfunduar provimet e magistraturës në drejtimin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës.

Në nëntor të vitit 1998 emërohet komandant i Zonës Operative të Nerodimes. Pas përfundimit të luftës emërohet Komandant i zonës së gjashtë të TMK-së me gradën Gjeneralmajor. Është dekoruar nga KPA (Këshilli i Përkohshëm Administrativ me dekoratën Urdhër “ Adem Jashari”) si dhe nga Gjenerali amerikan z. Kraedok etj. Nga viti 2007 kryetar i Komunës së Lipjanit në dy mandate.

Premtimet e Kryetarit Shukri Buja

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Shukri Buja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, në mes të tjerash Kryetari Buja ka premtuar:

- ✓ Krijimi i zonës së re industriale në Kërqevë për akomodimin e 200 Bizneseve dhe punësimin e 2000 personave,¹
- ✓ Fillimin e ndërtimit të zonës industriale me sipërfaqe 20 ha afër QMI-së dhe punësimin e 800 personave¹
- ✓ Krijimin e Lipjanit si qendër agrobiznese¹
- ✓ Renovimin e të gjitha shkollave dhe krijimin e kushteve hapësinore për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasë nga 37 në 25,¹
- ✓ Rregullimin e parkingjeve publike,¹
- ✓ Zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit në katër korsi të qarkullimit,¹
- ✓ Asfaltimin e rrugëve në të gjitha lagjet e qytetit,¹
- ✓ Krijimin e hapësirave të mjaftueshme të parqeve si dhe parkingjeve publike,¹
- ✓ Futjen e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrave mbi 150 km
- ✓ Asfaltimin rrjetit rrugor mbi 70 km
- ✓ Sistemin e rrjetit të ujësjellësit mbi 100 km
- ✓ Ndërrimin e pllakave në dysheme, dyerve dhe dritareve në Q.K.M.F në Lipjan
- ✓ Rregullimin e ngrohjes qendrore në Lipjan
- ✓ Zvogëlimin e papunësisë dhe të varfërisë
- ✓ Mbështetjen e ekonomive familjare
- ✓ Riaktivizimin dhe pasurimin e bibliotekave shkollore
- ✓ Hartimin e projekteve bujqësore
- ✓ Rregullimin dhe zgjerimin e sheshit “Adem Jashari”
- ✓ Krijimin e lehtësirave administrative dhe teknike për nxitjen e investimeve të huaja
- ✓ Uljen e taksave mbi investimet që krijojnë vende pune

¹ Premtime nga programi zgjedhor 2009 i PDK-së nëntor 2009

- ✓ Renovimin e të gjitha shkollave dhe kompletimin me infrastrukturë me qëllim të krijimit të kushteve sipas standardeve evropiane
- ✓ Rregullimin e nxehjes qendrore në të gjitha shkollat dhe rregullimin e rrethove të oborreve të shkollave sipas modelit të shkollës "Mehmet Akif"
- ✓ Përmirësimin e infrastrukturës sportive
- ✓ Sinjalizimin horizontal dhe vertikalë të rrugëve
- ✓ Transporti publik urban dhe ndër urban me mjete transporti uniforme
- ✓ Furnizimi të pandërprerë me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza
- ✓ Ndriçimin e të gjitha rrugëve të qytetit
- ✓ Përkrahje e vazhduar e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës
- ✓ Implementimin e vendimit të KK Lipjanit për lagjen e kategorive të luftës së UQK-së
- ✓ Zgjerimin e qytetit në drejtim të lumit sitnica, si dhe rregullimin e shtratit të lumit, parqeve dhe pushimoreve përgjatë lumit në sipërfaqe 250 ha
- ✓ Punësimin e rasteve sociale;
- ✓ Sistemimin e veteranëve të luftës dhe kategorive të dala nga lufta;
- ✓ Përkrahjen e vazhdueshme të familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës;
- ✓ Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;
- ✓ Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanasve;
- ✓ Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;
- ✓ Administratë digjitale;
- ✓ Renovimin e stadiumit të qytetit;
- ✓ Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes);
- ✓ Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;
- ✓ Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;
- ✓ Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;
- ✓ Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;
- ✓ Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë;

- ✓ Ndërtimin e dhjetë fabrikave;
- ✓ Zhvillimin e turizmit;
- ✓ Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave.

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.


0- tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
 1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,
 2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
 3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,
 4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe,
 5- tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.

Vërejtje: Premtimet janë për periudhën katër vjeçare 2009/2012. Deri tani është shpenzuar 3/8 e kohës.

Premtimet	vlerësimi
Krijimi i zonës së re industriale në Kërqevë për akomodimin e 200 Bizneseve dhe punësimin e 2000 personave	1
Fillimin e ndërtimit të zonës industriale me sipërfaqe 20 ha afër QMI-së dhe punësimin e 800 personave	1
Krijimin e Lipjanit si qendër agrobiznese	0
Renovimin e të gjitha shkollave dhe krijimin e kushteve hapësinore për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasë nga 37 në 25	2
Zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit në katër korsi të qarkullimit	0
Asfaltimin e rrugëve në të gjitha lagjet e qytetit	2
Krijimin e hapësirave të mjaftueshme të parqeve si dhe parkingjeve publike	1
Futjen e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrave mbi 150 km	2
Asfaltimin rrjetit rrugor mbi 70 km	3
Sistemin e rrjetit të ujësjellësit mbi 100 km	3
Ndërrimin e pllakave në dysheme, dyerve dhe dritareve në Q.K.M.F në Lipjan	1
Rregullimin e ngrohjes qendrore në Lipjan	0
Zvogëlimin e papunësisë dhe të varfërisë	0
Mbështetjen e ekonomive familjare	0
Riaktivizimin dhe pasurimin e bibliotekave shkollore	1
Hartimin e projekteve bujqësore	1
Rregullimin dhe zgjerimin e sheshit "Adem Jashari"	1
Krijimin e lehtësirave administrative dhe teknike për nxitjen e investimeve të huaja	0
Uljen e taksave mbi investimet që krijojnë vende pune	0
Renovimin e të gjitha shkollave dhe kompletimin me infrastrukturë me qëllim të krijimit të kushteve sipas standardeve evropiane	1
Rregullimin e nxehjes qendrore në të gjitha shkollat dhe rregullimin e rrethove të oborreve të shkollave sipas modelit të shkollës "Mehmet Akif"	0

Përmirësimin e infrastrukturës sportive	0
Sinjalizimin horizontal dhe vertikalë të rrugëve	2
Transporti publik urban dhe ndër urban me mjete transporti uniforme	4
Furnizimi të pandërprerë me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza	4
Ndriçimin e të gjitha rrugëve të qytetit	2
Zgjerimin e qytetit në drejtim të lumit sitnica, si dhe rregullimin e shtratit të lumit, parqeve dhe pushimoreve përgjatë lumit në sipërfaqe 250 ha	1
Implementimin e vendimit të KK Lipjanit për lagjen e kategorive të luftës së UQK-së	2
Përkrahje e vazhduar e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës	4
Punësimin e rasteve sociale;	0
Sistemimin e veteranëve të luftës dhe kategorive të dala nga lufta;	2
Përkrahjen e vazhdueshme të familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës;	4
Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;	0
Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanase;	0
Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;	0
Administratë digjitale;	1
Renovimin e stadiumit të qytetit;	0
Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes);	0
Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;	0
Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;	3
Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;	0
Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;	0
Zhvillimin ekonomik sidomos në fushën e bujqësisë;	0
Ndërtimin e dhjetë fabrikave;	0
Zhvillimin e turizmit;	0
Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave;	0

- 22 premtime ose 47.82% pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
- 10 premtime ose 21.73% ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
- 7 premtime ose 15.21% ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3 premtime ose 6.52% procesi ka filluar dhe në rrugë të mirë,
- 4 premtime ose 8.69% ka hapa konkrete dhe kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë,
- Nuk kemi asnjë premtim të realizuar plotësisht.



Problemet aktuale

Edhe pse një komunë me një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe me potenciale të mëdha për zhvillim ekonomik, qytetarët e Komunës së Lipjanit përballen me të njëjtat problema sikurse pjesa tjetër e Kosovës. Edhe në këtë komunë brenga më e madhe e qytetarëve mbetet papunësia dhe varfëria. 48.91% e qytetarëve në këtë komunë janë të papunë. 12.16% e qytetarëve janë të varur nga ndihmat sociale. Përveç këtyre problemeve, probleme më specifike për komunën e Lipjanit janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Mungesa e një parku dhe hapësirave gjelbëruese;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim, edhe pse ne kemi bërë vërejtje në raportin e parë, dytë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2007-ta dhe 2009-ta nga kryetari i komunës Z. Shukri Buja.

Mungesa e parkut dhe hapësirave gjelbëruese. Në këtë drejtim kemi lëvizje krahasuar nga raport i kaluar, por edhe jo aq sa është premtuar gjatë fushatës zgjedhore. Ka filluar të realizohet projekti i parkut gjelbërues në hapësirat ku janë rrënuar barakat e bizneseve. Por, kemi problemi të theksuar edhe në vendet e ndryshme që gjenden në brendi të qytetit. Organizata YAHR ka dalë edhe me një reagim konkret dhe përcjellë shqetësimin e banoreve të qendrës së qytetit ndaj institucioneve komunale lidhur me mos mirëmbajtjen e këndit të vetëm të lojërave për fëmijë në qytet, i cili është ndërtuar në vitin 2006 për rekreacion dhe argëtimin e fëmijëve dhe i cili gjendet brenda hapësirës së ndërtesës së Kuvendit komunal. Ky këndi i lojërave jo vetëm që nuk është mirëmbajtur, por është shëndruar në një deponi të mbeturinave dhe një vend atraktiv për qentë endacak që njëkohësisht po i rrezikojnë fëmijët e kësaj qendre të qytetit. Dhe është kërkuar nga administrata komunale, inspektorati komunal dhe kryetari i komunës Z. Shukri Buja që të ndërmarrë ndonjë veprim në përmirësimin e gjendjes dhe kthimin e këtij

këndi të lojërave për fëmijë në një gjendje të mëparshëm i cili do të ishte në shërbim të fëmijëve të qytetit.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimin e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Kemi vetëm një iniciativë nga kryetari të komunës për shpalljen e qytezës së Janjevës si qytet-muze , por ju ndonjë veprim konkretë.



Organizata Joqeveritare YAHR ka reaguar ashpër me 27 prill 2011 nëpër mes komunikatës për media ku ka shprehur shqetësimin e qytetarëve të qytetit të Lipjanit ndaj shëmtimit të pamjes në hyrje të qytetit të Lipjanit tek ura mbi lumin Sitnica në udhëkryqin (Lipjan-Magure dhe Prishtinë-Shtime) nga personat e pa ndërgjegjshëm të cilët me hedhjen e mbeturinave të ngurta ndërtimore kanë krijuar një deponi të egër të mbeturinave, me një pamje të vrazhdë jonjerëzore në para hyrje të qytetit të Lipjanit. Ku jo vetëm që është shkatruar kjo pamje ,por është bërë edhe ndotja ambientit nga materiet e ndryshme kimike të hedhura në këtë vend afër lumit

Sitinica.

Po ashtu organizata jonë ka reaguar ashpër ndaj departamentit komunalë të inspektoratit i cili nuk ka qenë efikas në parandalimin e këtyre dukurive dhe është bashkë fajtores në krijimin e një gjendje të tillë.

Dhe kemi kërkuar nga ekzekutivi i komunës së Lipjanit, gjegjësisht nga kryetari i komunës së Lipjanit që me autoritetin e vetë që të intervenojë dhe të parandalojë këtë dukuri negative dhe që të ja kthejë pamjen e bukuri që ka qenë në hyrje të qytetit të Lipjanit.

Me 9 Prill 2011: YAHR reagon dhe shpreh shqetësimin ndaj subjekteve politike që veprojnë në komunën e Lipjanit. Për mos gatishmërinë për të kontribuar në mirëqenien e qytetarëve të komunës së Lipjanit. Subjektet politike që veprojnë në komunën e Lipjanit (PDK, LDK, AKR, AAK etj.) nuk kanë qenë të gatshëm që të kontribuojnë në krijimin e mekanizmave lokal të përfaqësimit të interesave të fshatrave të komunës së Lipjanit. Ku vazhdimisht kanë bllokuar procesin e formimit të këshillave të fshatrave, për interesa të tyre partiake e jo në interes të qytetareve. Ku dihet se mekanizmi më i mirë i përfaqësimit të interesave të qytetarëve nëpër fshatra është këshilli i fshatit dhe kryetari i këshillit të fshatit.

Është kërkuar nga subjektet politike që veprojnë në komunën e Lipjanit që të s'bllokojnë procesin e formimit të këshillave të fshatrave dhe të jenë më bashkëpunuese me shoqërinë civile për interes të qytetarëve në komunën e Lipjanit. Dhe që të lejnë interesat e ngushta partiake në të mirë dhe në interes të qytetarëve në 62 fshatra të Komunës së Lipjanit.

Si problem tjetër gjatë muajit Prill 2011, që janë përballur qytetarët e Komunës së Lipjanit, gjegjësisht qytetarët e fshatrave: Marevc, Gllavicë, Qallapek, Sllovi dhe Smallushë, ishte ndërprerja kolektive të rrymës elektrike.

Veprimet ndërmarra nga ana KEK-ut ishin të paligjshme, për shkak të shkyçjeve kolektive nga energjia elektrike si dhe marrja e transformatorëve në këto fshatrave të komunës.

Shkyçjet kolektive që ishin aplikuar nga KEK –u që nga data 23 mars deri me 30 Prill 2011 në fshatrat Marevc, Gllavicë, Qallapek, Sllovi dhe Smallushë nuk kishin asnjë justifikim ligjor dhe arsyeshmëri për një metodë të tillë të dënimit kolektiv ndaj qytetarëve. Madje veprimet e KEK-ut shkuan deri në atë masë sa që në fshatrat Sllovi dhe Smallushë ishin tërhequr krejtësisht dhe ishin marr me vete nga dy trafo në këto dy fshatra, njëra nga këto transformatorë ishte investim i vetëfinancuar nga banorët e fshatit Smallush.

Përshkrim i realizmit të punëve

Kryetari i komunës së Lipjanit Z. Shukri Buja ka dal me raportin e punës për vitin 2010. Ku kryetari i komunës ka pasur 534 takime, 197 takime zyrtare me institucionet e Republikës së Kosovës dhe 337 takime të ndryshme me qytetarët. Sipas raportit thuhet se ka pasur 337 kërkesa të ndryshme nga qytetarët, subjektet afariste dhe OJQ-të, por nuk përmendet numri se sa prej tyre janë realizuar, që është një mangësi e madhe në këtë raport.

EKZEKUTIVI I KOMUNËS SË LIPJANIT 2011			
	Kryetari i Komunës së Lipjanit: Shukri Buja shukribuja@hotmail.com		Nënkryetari i Komunës së Lipjanit: Banush Bytyçi, fakulteti Filozofik dega e filozofi-sociologjisë 038 581 176
	Nënkryetari i Komunës së Lipjanit: Florent Hoxha Shkolla e Lartë Teknike		Drejtorati për Administratë Sefer Krasniqi Magjistër i Shkencave Juridike
	Drejtorati për Shërbime Publike Avni Limani, Ekonomist i diplomuar		Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim Haqif Drenica, shkollën e lartë –Batin
	Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari Armend Agushi, Fakultetin e kryer të shkencave matematiko natyrore, 044/ 840 969 armend-agushi@hotmail.com		Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim Mendim Luma Ekonomist i diplomuar 044 206 012

	Drejtoria për Inspeksion Bajram Rizani, shkollën e lartë – Matematikën, 044 172 813		Drejtoria për Arsim Nazmi Krasniqi Kimist i diplomuar 044 207 086
	Drejtoria për Urbanizëm Edmond Rexhepi inxhinjer i diplomuar i Komunikacionit, 044 363 048 edmondrexha@gmail.com		Drejtoria për Buxhet dhe Financa Petrit Kelmendi Ekonomist i diplomuar 044 626 277 p_kemendi@hotmail.com
	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Fitim Mziu Doktor i Mjekësisë Familjare 044 674964		Drejtoria për Prokurim Ragip Zejnullahu, Ekonomist i diplomuar 044 130 952 Email: rzejnullahu@hotmail.com
	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Halit Gashi Jurist i diplomuar, 044 206 566		Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Agim Bylykbashi Profesor i gjuhës shqipe, 044 883 921

Gjendja ekonomike dhe sociale

Komuna e Lipjanit në mbledhjen e tretë të datës: 31 mars 2010 Kuvendi Komunal i Lipjanit e aprovon propozim vendimin për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2010-2015 dhe u formua komisioni i përbërë prej 11 anëtarësh , deputet dhe ekspertë të lëmive të ndryshme të cilët do të merren me hartimin e strategjisë Zhvillimore.

Gjendja ekonomike dhe Sociale në komunë e Lipjanit është shumë e vështirë edhe pse është premtuar nga kryetari Buja gjatë fushatës zgjedhore 2009 se do të punësojë mbi 5,000 persona gjatë periudhës katër vjeçare. Prapë kemi në një nivel të lartë të pa punëve. Ku në maj 2011 në Zyrën Komunale për Punësim i kemi të regjistruar 9,436 si të papunë. Kjo shifër do të thotë se është me madhe, ku kemi parasysh shumë raste që nuk janë të regjistruar në këtë zyre dhe numri total i të pa punëve në komunën e Lipjanit sillet diku në 28 mijë e gjashtë qind , afër 48% e popullatës.

Po ashtu kemi një numër të madhe të rasteve sociale. Ku në bazë të statistikave në muajin Maj të vitit 2011, kemi përfitues të asistencës sociale 1,569 familje me 7,584 anëtarë diku mbi 12.64% e popullatës së përgjithshme të Komunës së Lipjanit. Krahasuar në mes periudhës Maj 2010 dhe Maj 2011 kemi një ulje të vogël me 29 familje me 32 anëtar të familjeve.

Problemi më i madh social që është shkaktuar në komunën e Lipjanit ishte problemi i shkaktuar në muajin prill 2011 nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS)/Departamenti i Mirëqenies Sociale e cila i kishte hequr nga skema e asistencës sociale 249 familje përfituese në komunën e Lipjanit. Që ishte një YAHR – Raporti monitorues 3, mbi punën e ekzekutivit të Komunës të Lipjanit

veprim i pa ndërgjegjshëm i kësaj ministrie që kishte shkaktuar problem në ekzistencën e mbi jetesës së 249 familjeve me mbi 1,300 anëtar.

Tabela 2: Numri i të papunëve të regjistruar në Zyrën komunal për Punësim në Lipjan

Periudha kohore	Nr. Llogaritur i të pa punëve të cilët nuk janë të regjistruar	Të papunë të regjistruar në ZKP në Lipjan	Të punësuar nga ZKP në Lipjan
2008	27,000	10,014	184
2009	27,400	9,740	258
2010	28,000	9,487	76
2011	28,600	9,436	219

Tabela 3: Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale në Komunën e Lipjanit

Periudha kohore	familje	Anëtarë të familjeve
Maj 2009	1,481	7,022
Maj 2010	1,598	7,616
Maj 2011	1,569	7,584

Transparenca dhe llogaridhënia

Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Shukri Buja ka qenë edhe transparenta dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi shoqërinë civile. Megjithëse transparenta e kësaj komune është në nivel më të mirë në krahasim me disa institucione dhe komuna të tjera, mbetet shumë për tu dëshiruar dhe përmirësuar në aspekt të llogaridhënies dhe transparencës.

Që nga 16 prill i vitit 2010 organizata YAHR në vazhdimësi ka kërkuar nga ekzekutivi i komunës së Lipjanit për hartimin e një plani komunal të veprimit për transparentë e cila është dashur që të jetë produkt i rregullores komunale për transparentë të miratuar nga kuvendi Komunal të datës 20.03.2009. Neni 9. Alineja 9.1. një gjë e tillë nuk është bërë deri më sot.

Kemi lëvizje pozitive tek uebfaqja e komunës në krahasim me periudhën e kaluar, por edhe këtu ekzistojnë mangësi në vonesën e informimit të qytetareve dhe mungesën e informacioneve tek profilet e këshilltareve komunal.

Duhet përshëndetur edhe vendimin në muajin Gusht 2010 të kryetarit Z. Shukri Buja për bërjen publike të raporteve javore të punës së drejtoreve të drejtorive.

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për gjashtëmujorin e parë të vitin 2010 ka arrit që të shpenzohet në masën 30 % ose **2,531,409.60€** nga buxheti i planifikuar për vitin 2010 8,456,417.00 €. Kjo shifër është shifra më e ultë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë.

Mirëpo, pjesa më e madhe e pritjet të shpenzohen gjatë gjashtë mujorin e fundit të 2010. Komuna e Lipjanit gjatë nëntëmujorit të vitit 2010 ka arrit që të tejkalojë parashikimeve e të hyrave vetanake prej 935.159.00 € në 1,285,000 €. Kjo është shifra më e lartë që një komunë ka arritur që të regjistroj me rastin e arkëtimit të hyrave vetanake gjatë këtyre viteve.

Tabela 4:

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2010	4,758,026 ▲	513,941 ▲	118,443 ▼	80,000 ■	2,986,007 ▲	8,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

Tabela 5: Përmbledhje e planit buxhetor 2011-2013, në euro

Përmbledhje e planit buxhetor 2011-2013, në euro	Plani buxhetor 2011	Vlerësimet buxhetore 2012	Vlerësimet buxhetore 2013
	1	2	3
Granti i përgjithshëm	3,348,298.00	3,500.000.00	3,600.000.00
Granti për arsim	3,845,726.00	3,950,000.00	4,242,400.00
Granti për shëndetësi	1,087,835.00	1,239,322.00	1,300.000.00
Granti per A.P.K	25,968.00	40,000.00	50,000.00
Granti Specifik shërb. Sociale	32,163.00	55,000.00	60,000.00
Gjithsej HVK	964,846.00	992,678.00	1,013,400.00
Gjithsej shpenzimet	9,304,836.00	9,777,000.00	10,265,800.00

Tabela 6:	Plani buxhetor 2011	Struktura buxhetore 2011(në %)	Vlerësimi buxhetor 2012	Vlerësimi buxhetor 2013
	1	2	3	4
Paga e mëditje	5,016,355.00	53.91%	5,260,057.40	5,350,289.91
Mallra e shërbime	528,400.00	5.67%	587,122.70	768,390.25
Shërbime komunale	119,667.00	1.28%	127,320.00	127,320.00
Subvencione	82,510.00	0.88%	83500.00	85,000.00
Shpenzime kapitale	3,557,904.00	38.23%	3,719,000.00	3,934,800.00
Gjithsej	9,304,836.00	100.00%	9,777,000.00	10,265,800.00

Tabela 7: Plani i shpenzimeve sipas Programeve për Vitet:2011-2013

Plani i shpenzimeve sipas Programeve për Vitet:2011-2013	Plani buxhetor 2011	Struktura Buxhetore 2011(në %)	Vlerësimi buxhetor 2012	Vlerësimi buxhetor 2013
	1	2	3	4
Zyra e Kryetarit	187,143.00	2.01	180,000.00	185,000.00
Administrata dhe Personeli	249,866.66	2.69	240,000.00	245,000.00
Inspeksioni	51,441.00	0.55	53,000.00	54,000.00
Prokurimi	26,876.00	0.29	28,000.00	30,000.00
Buxhet dhe Financa	67,213.00	0.72	70,000.00	73,000.00
Shërbimet Publike, Mbrojtje civile dhe Emergjencia	2,597,656.00	27.82	3,544,005.00	3,407,000.00
Zyra e Kryesuesit Kuvendit	84300.70	0.86	100,000.00	105,000.00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	61,712.00	0.66	63,000.00	65,000.00
Zhvillim Ekonomik	22,408.00	0.24	24,000.00	26,000.00
Kadastër dhe Gjeodezi	38,896.00	0.42	41,000.00	45,000.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	292,555.64	3.14	30,000.00	32,000.00
Kujdesi Primar shëndetësor	1,216,822.00	13.12	1,263,000.00	1,393,000.00
Pagesa për Performancën në shëndetësi	45,742.00	0.49	46,000.00	47,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	414,955.00	4.46	78,000.00	80,000.00
Arsim dhe shkencë	3,947,240.00	42.42	4,016,995.00	4,478,800.00
GJITHSEJ	9,304,835.94	100.00	9,777,000.00	10,265,800.00

Investimet kapitale

Në periudhën janar-qershor 2011, buxheti i ndarë për investime kapitale **2,986,007 €** është realizuar në masën 8.59 %.. Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2011- 2013. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Lipjanit do të ketë në dispozicion 11,211,704.00 € për investime kapitale.

Tabela 8: Investimet kapitale për periudhën 2011

	Investimet kapitale	Nga të hyrat vetanake (€)	ga grantet qeveritare (€)	REALIZIMET
1	Kanalizimi në: Gadime e Ulët-G. Epërm, Faza e II	150,000	150,000	x
2	Kanalizimi në: Banullë-Glllogovc, Faza e II	120,000	120,000	Në implementim
3	Kanalizimi në: Sllovi, Faza e II	130,000	130,000	x
4	Kanalizimi në: Topliqan, Faza e II	100,000	100,000	Në implementim
5	Asfaltimi i rrugës në: Babush i Muhaxherëve	270,000	270,000	x
6	Asfaltimi i rrugës në: Rubovc-Llugaxhi	80,000	80,000	x
7	Asfaltimi i rrugës në:Krojmir faza e IV	100,000	100,000	Tenderim
8	Asfaltimi i rrugës në:Brus	80,000	80,000	
9	Asfaltimi i rrugës në:Shalë	100,000	100,000	Tenderim
10	Asfaltimi i rrugës Sllovi-Tërbovc	50,000	50,000	
11	Asfaltimi i rrugëve të Lipjanit: Xh.Breznica,B.Krasniqi, R.Akllapi, M.Kopiliqi, L.Illugiqi, B.Vukmirovic,D.Tucoviq, Shtat Shtatori, Një Maji,B.Gërbeshi	473,904	198,281	x
12	Asfaltimi i rrugës në: Kleqkë	70,000	70,000	Në implementim
13	Asfaltimi i rrugës në: Marevc	70,000	70,000	x
14	Asfaltimi i rrugës në: Llugë	80,000	80,000	Në implementim
15	Ndërtimi i objektit Komunal-Lipjan	200,000		x
16	Shpronësimi i Pronave	70,000		x
17	Bashkëfinancim me donator	150,000		Në implementim
18	Rregullimi i Parqeve të Qytetit	120,000		Në implementim
19	Hartimi i Projekteve Detale	80,000	80,000	Në implementim
20	Hartimi i Planit rregullator	45,000	45,000	x
21	Hartimi i Projektit Detal Urban-Faza II	40,000	40,000	x
22	Precizimi i Zonave Kadastrale qytetit-Lipjan	40,000	40,000	x
23	Digjitalizimi i infrastrukturës nëntokësore	30,000	30,000	x
24	Revidimi i planit zhvillimor	30,000	30,000	x
25	Ndërtimi shtëpisë së shëndetit Sllovi	50,000	50,000	x
26	Ndërtimi shtëpisë së shëndetit Smallush	30,000	30,000	x
27	Renovimi i QKMF	70,000	70,000	x
28	Ndërtimi i sallës Sportive Shalë	80,000	80,000	x
29	Ndërtimi i sallës Sportive Llugaxhi	80,000	80,000	x
30	Renovimi i qendrës sportive „Tahir Sinani"	100,000	100,000	tenderim
31	Renovimi i shtëpisë së kulturës Magure	80,000	80,000	x
32	Ndërtimi i Shkollës Filllore Glllogovc	100,000	100,000	x
33	Ndërtimi i Shkollës Filllore Bujari	80,000	80,000	x
34	Ndërtimi i Shkollës Filllore Kraishtë	100,000	100,000	tenderim
35	Renovimi i Shkollës Filllore Gadimem e Epërme	80,000	80,000	tenderim
36	Renovimi i shkollës fillore: Kleqkë	20,000	20,000	x

Tabela 9: Investimet kapitale për periudhën 2011/2013

Programi/përshkrimi	2011 Plani	2012 Vlerësimi	2013 Vlerësimi	Shpenzimet totale 2011-2013
Realizimi I ujësjellësit Kraisht, Grac. Vog, Bujan, Topliqan		400000		400000
Realizimi I ujësjellësit-Leletiq		52500		52500
Realizimi I ujësjellësit-vershevc		67500		67500
Realizimi I ujësjellësit-Zllakuqan		85825		85825
Realizimi I ujësjellësit-Mirenë		52000		52000
Realizimi I ujësjellësit-Akllap		90000		90000
Realizimi I ujësjellësit-Ribar I Madhë		82500		82500
Bashkëfinancim me donator		270000		270000
Rregullimi i Parqeve të Qytetit		250000		250000
Sinjalizim Vertikal dhe Horizontal		40000		40000
Kanalizimi në fshatin-Baincë			200000	200000
Kanalizimi në fshatin-Bregu i Zi			200000	200000
Kanalizimi në fshatin-Brus			150000	150000
Kanalizimi në fshatin-Bukovic			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Divjak			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Dobraj e Vogel			84000	84000
Kanalizimi në fshatin-Teqe			150000	150000
Kanalizimi në fshatin-Terbuvc			80000	80000
Kanalizimi në fshatin-Torinë			150000	150000
Kanalizimi në fshatin-Gllanicë			84000	84000
Kanalizimi në fshatin-Gllavicë			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Hallaq I Madhë			60000	60000
Kanalizimi në fshatin-Janjevë			150000	150000
Kanalizimi në fshatin-Kleqkë			150000	150000
Kanalizimi në fshatin-Kojskë			120000	120000
Kanalizimi në fshatin-Llugë			120000	120000
Kanalizimi në fshatin-Marevcë			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Mirenë			200000	200000
Kanalizimi në fshatin-Qallapek			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Qylagë			100000	100000
Kanalizimi në fshatin-Risinovc			150000	150000
Mirëmbajtja e rrugëve te Asfaltuara			90000	90000
Mirëmbajtja e rrugëve kategorisë .IV			80000	80000
Bashkëfinancim me donator			325000	325000
Mirëmbajtje e Ndriçimit Publik			64000	64000
Ndërtimi shtëpisë së shëndetit Sllovi	50000			50000

Ndërtimi shtëpisë së shëndetit Smallush	30000			30000
Renovimi I QKMF	70000			70000
Renovimi I QKMF-së		150000		150000
Renovimi I qendrave Mjeksis Familjare			175000	175000
Ndërtimi I sallës Sportive Shalë	80000			80000
Ndërtimi I sallës Sportive Ilugaxhi	80000			80000
renovimi I qendrës sportive „Tahir Sinani"	100000			100000
Renovimi I shtëpisë së kulturës Magure	80000			80000
Ndërtimi I Shkollës Fillore Gllgovc	100000			100000
Ndërtimi I Shkollës Fillore Bujari	80000			80000
Ndërtimi I Shkollës Fillore Kraisht	100000			100000
Ndërtimi I Shkollës Fillore Gadimem e Eper.	80000			80000
Renovimi I shkollës mesme „Adem Gllavica		204995		204995
Ndërtim I shkollave ne Komunën e Lipjanit			400000	400000
Ndërtimi I fushave Sportive			152800	152800

Drejtoria e prokurimit

Drejtoria e Prokurimit vitin buxhetor të planifikuar 2011 e ka filluar me një vonesë të konsiderueshme, për arsye të zgjedhjeve jashtëzakonshme në nivel nacional të cilat u vonuan (deri në vendosjen e ekzekutivit të ri). Kjo vonesë është reflektuar sidomos në fillimin e procedurave të prokurimit për projektet kapitale.

Drejtoria e prokurimit prej muajit janar 2011 deri në muajin Maj 2011 ka shpallur 20 tender të ndryshme duke filluar prej furnizimeve me material shpenzues për zyre deri tek investimet kapitale.

Administrata komunale

Në vitin 2011, në Komunën e Lipjanit kemi rritje të numrit të punëtorëve në krahasim me një vit më parë, në tre sektorët publik (arsim 1,068, shëndetësi nga 233 në vitin 2010 në 234 në këtë vit , administratë nga 182 në vitin 2010 në 205 në vitin 2011) janë të punësuar gjithsej 1,483 qytetarë. Vetëm në administratën komunale janë të punësuar momentalisht 205 shërbyes civil që do të thotë 23 shërbyes civilë më shumë krahasuar me një vit më parë.. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 10/46, ku sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë administratat lokale duhet të kenë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Lipjanit me rreth 60,000 banorë duhet të ketë më së shumti 97 shërbyes civil. Sipas kësaj, administrata komunale e Lipjanit është e tej ngarkuar me staf.

Kemi një përpjekje nga administrata komunale në Lipjan në digjitalizimin e shërbimeve të ofruar qytetarëve dhe në sistemin e brendshëm të komunikimit në mes nëpunësve. Po ashtu nga muaji Maj 2011 ka filluar procedimin e lëndëve në mënyrë elektronike, që është një shenjë pozitive për administratën komunale.

Gjendja në arsim

Në Komunën e Lipjanit arsimi zhvillohet në dy nivele, në atë fillor dhe të mesëm. Në këtë komunë funksionon një çerdhe për fëmijë, 57 shkolla fillore (23 shkolla amë me 34 paralele të ndara) dhe 4 shkolla të mesme (3 shkolla amë me një paralele të ndarë). Po ashtu nga buxheti i komunës financohen një çerdhe dhe tri shkolla nga komuniteti serb edhe pse këto institucione punojnë me plan program të administratës së republikës së Serbisë.

Gjatë vitit 2010, kanë përfunduar ndërtimi i shkollave fillore në: Gadime, Blinajë dhe Putorovc dhe në këtë vit pritet fillimi i ndërtimit i katër shkollave fillore në Kraishtë, Bujari, Gllogovc dhe në Gadime të ultë.

Edhe pse gjatë vitit 2009 shumë është folur që do të ndërtohet edhe një qendër universitare, nuk kemi asnjë lëvizje gjatë viteve 2010/2011. Edhe pse komuna I ka ndarë 5 hektar tokë një institucioni turk të arsimit të lartë QEA "Gulistan".

Gjendja në shëndetësi

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë një QKMF, 4 QMF dhe 6 ambulant të mjekësisë familjare. Vetëm në QKMF në qytetin e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, kurse në QMF punohet pesë ditë në javë për 12 orë në ditë. Tri ambulantë punojnë vetëm dy ditë në javë për tetë orë në ditë. Në shëndetësinë primare të Lipjanit janë të punësuar 234 punonjës, prej tyre 132 femra, ku vetëm një femër është në pozitë udhëheqëse. Sipas vetë zyrtarëve të drejtoratit, Lipjani ka mjaft kuadro shëndetësore, ka 21 specializant të mjekësisë familjare. Në mungesë të një spitali regjional në Prishtinë, rastet më të rënda të gjithë drejtohen në QKUK.

Gjendja në institucionet shëndetësore në komunën e Lipjanit është shumë e rënd, e sidomos edhe më shumë e vështirëson mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me barna nga lista esenciale. Ku pacientet janë të detyruar që ti blejnë edhe gjërat me elementare (shiringat, dorëzat për infermierë, fashat etj.) në mënyrë që tu ju shërbehet atyre.

Po ashtu gjatë vitit të kaluar 2010 nuk ka pasur ndonjë investim kapital nga ana e ekzekutivit të komunës së Lipjanit me përjashtim të renovimit të objektit të njësisë së emergjencës. Ndërsa gjatë këtij viti 2011 janë paraparë ndërtimi i dy shtëpive të shëndetit në Sllovi dhe në Smollushë dhe renovimi i objektit të QKMF-së në Lipjan.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore:

Tabela 10: Tarifat e tatimit komunal në pronë

Destinimi i objektit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Norma e tatimit
Prona rezidenciale/shtëpi	400€	300€	200€	150€	0.12%
Prona rezidenciale/banesë	400€	300€	200€	150€	0.12%
Prona industriale	350€	300€	250€	200€	0.20%

Pronat bujqësore	200€	150€	100€	100€	0.15%
Garazhet	180€	150€	130€	100€	0.15%
Pronat komerciale	600€	400€	300€	200€	0.30%
Pronat të pa përfunduara	160€	120€	80€	60€	0.12%
Fushat sportive dhe pishinat	80€	80€	80€	80€	0.30%
Pronat e braktisura	400€	300€	200€	150€	0.05%
Pistat e aeroportit	-	400€	-	-	0.30%

Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Baza e të dhënave të cilën e disponon Komuna e Lipjanit është me plotë gabime, dhe ndodhë për të njëjtën pronë ti shënohet pronarit dy fatura të tatimit të ndryshme.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
7. Rifreskimi i kabinetit qeveritar i kryetarit të Komunës Shukri Buja me persona më energjik në disa drejtori në pjesën e dytë të këtij mandati;
8. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
9. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukturore;
10. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
11. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
12. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, Statutit komunal, Ligjit për transparencë dhe Rregullores komunale për transparencë të datës 20.03.2009. Duhet dhe është obliguar komuna të publikojë informacionet mbi aktivitetet që është duke i zhvilluar.

13. Kuvendi Komunal I Lipjanit është i obliguar nga vetë rregullorja që e ka miratuar të datës 20.03.2009. dhe nga ligji për vetëqeverisje lokale, statuti komunal, Udhëzimi administrativë të MPL 2008/03. Që sa më shpejtë të hartojë një plan të veprimit për transparencë të aktiviteteve të saj karshi qytetarëve të saj.
14. Racionalizimi i shpenzimeve të telefonisë mobile nga ana e ekzekutivit komunal
15. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,
16. Automatizimi i sistemit të faturimit,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Maj, 2011.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2010. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2009 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2011.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002, 2007 dhe 2009. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2010.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2011.
16. Programi zgjedhor i PDK-së dega Lipjan , Nëntor 2009,
17. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , Tetor 2009,
18. Zyra Komunale për punësim në Lipjan. Maj 2011,
19. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Maj 2011

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center

